



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE URBANE

Elbasan, më .02.2024

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROCEDURËS-“Blerje fishekzjarre për festat e vitit 2024”

LLOJI PROCEDURËS - “Procedurë e hapur e thjeshtuar – mallra”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV:
Fishekzjarre-24613200-6

VLERA E FONDIT LIMIT - **1,249,167** (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa t.v.sh.**

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si mëposhtë:

Shtojca 7

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentimi: Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 03 Datë 09.06.2021 te miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Formulari i Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Kriteret (a-c) jane vendosur ne perputhje me Dokumentat e Tenderit te miratuara nga APP bazuar ne Vendimit Nr. 03 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar ne Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”.

Pika b) eshte vendosur ne baze te nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojces 7;

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrata tatimore pergjate tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet të jete jo me e vogel se **40%** e vleres se fondit limit.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifate vendore për vitin 2023 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifate vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kriteri 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43 dhe nenit 55 pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe bazuar ne Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, date 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik".

Argumentimi: Kriteri 2.2.2 eshte vendosur bazuar ne nenin 76, pika 2 te LPP sidhe ne ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" I ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20% e vleres se perllorarit te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.**

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara,

ose

- b) Në rast se **pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, te plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kriteri 2.3.1 është vendosur referuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4 germa b) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **licensën profesionale** për importin, eksportin dhe prodhimin e lëndëve piroteknike, fishekzjarre për përdorim civil, nga AKSHE (Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve).

Argumentimi: Këto kritere u vendosën në përputhje me parashikimet e bëra në ligjin Nr. 73/2021 për “Hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”, ligjin Nr. 73/2014 për “Disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9126, datë 29.7.2003, “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse dhe lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë në Republikën e Shqipërisë”, (të ndryshuar), VKM Nr. 932, datë 18.11.2015 për “Procedurën për dhënien e licencave të importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve për përdorim civil”, ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 për “Mbrojtjen e Mjedisit” si edhe në parashikimet e bëra në nenin 77, të Ligjit të posaçëm Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 40 pika 5 germa (a) të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. **Këto kritere gjithashtu janë vendosur nga AK duke marrë në konsideratë edhe faktin se operatori ekonomik fitues do të kryejë shërbimin e montimit, plasjes dhe pastrimit e ambjentit pas perfundimit të festës, si dhe duke qenë se menaxhimi i këtyre lëndëve ka rëndësi jetike dhe në këtë mënyrë është mbajtur parasysh të kerkohen licensat sa me sipër cituar.**

2.3.3 Operatori ekonomik të deklarojë se merr përsipër të realizojë shërbimin e montimit plasjes dhe pastrimit e ambjentit pas perfundimit të festës me stafin e operatorit ekonomik të licensuar sipas akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi.

Argumenti: Duke qënë se këto artikuj janë të një rëndësie të vecantë jetike dhe procesi i plasjes së tyre ka impakt të drejtpërdrejtë në komunitet është kërkuar që ofertuesit e mundshëm ekonomikë të marrin vetë përsipër të kryejnë procesin e shërbimit të montimit, plasjes dhe pastrimit të ambjentit duke qënë se kanë staf të specializuar dhe kualifikuar për realizimin me sukses të këtij shërbimi.

2.3.4 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale për realizimin me profesionalizëm të punës, duhet të ketë personel teknik/ 1 (një) Person me njohuri të specializuara në përdorimin e lëndëve piroteknike, i pajisur me dëshmi Zjarrmëtari (e vlefshme) lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikatën/ dëshmin për punonjësin e kërkuar; për të vërtetuar duhet të paraqesë kontratën e punës.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b), të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Kërkesa e vendosur nga AK për disponimin e personelit teknik/ Person me njohuri të specializuara në përdorimin e lëndëve piroteknike, i pajisur me dëshmi Zjarrmëtari (e vlefshme) është e domosdoshme pasi ky person zotëron njohuritë e duhura për realizimin e të gjithë procesit të montimit, plasjes e deri në pastrimin e ambientit nga mbetjet e lëndëve piroteknike për të shmangur çfarëdolloj problematike që mund të dalë gjatë procedurës së hedhjes së fishekzjarreve.

Rrjedhimisht AK mund t’u kërkojë ofertuesve të mundshëm ekonomikë të paraqesin dokumentacion lidhur me këto kërkesa. Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij si me lart, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohet për besueshmerinë, cilësinë dhe kapacitetet e ofertuesve. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.5 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Një mjet transporti të pajisur me certifikatën ADR ”Për transportin e mallrave të rrezikshëm”, (e vlefshme) e lëshuar nga Autoriteti përkatës

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit;
- leje qarkullimi;
- certifikatën e kontrollit teknik;
- siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);
- certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).

b) Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet:

- dokumenti që verteton regjistrimin e tij;
- leje qarkullimi;
- certifikatën e kontrollit Teknik
- siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);
- certifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates, objekt i këtij prokurimi.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij **kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.** Referuar specifikimeve teknike dhe kërkesave të percaktuara nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e këtij objekti prokurimi dhe realizimin e proceseve të punës sa me sipër cituar lindi e nevojshme edhe disponimi i mjetit të transportit i pajisur me certifikatën ADR “Për transportin e mallrave të rrezikshëm”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJESIA E PROKURIMIT